

Dalës-Izlazns

Nr. -I-141  
Br.

Data 30.10.2023  
Datum



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E OBILIQIT  
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC

**KUVENDI KOMUNAL OBILIQ**

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly of Obilić

Në mbështetje të nenit 12.2, pika d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare nr.28 të dt.04.06.2008), bazuar në nenin 44.1 dhe 47.3, të Statutit të Komunës nr.-I-34, të dt.25.04.2016, bazuar në Ligjin nr.04/L-010 për bashkëpunimin ndërkomunal, neni 8 pika 2 bazuar në vendimin nr.-I-179, të dt.29.12.2022, për të hyrë në bashkëpunim ndërkomunal dhe Autorizimin për ti filluar konsultimet për marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal, si dhe nenin 39 të Rregullores së punës së Kuvendit, Kuvendi Komunal pas shqyrtimit të kërkesës n.-II-1458, të dt.16.10.2023 së Kryetarit të Komunës, në mbledhjen e mbajtur me dt. 30.10.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet marrëveshja me nr.-II-1338, e dt.26.09.2023, ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe kryeqytetit të Republikës së Kosovës Prishtina, për realizimin e projekteve që dalin nga marrëveshja e projektit të ngrohjes diellore "Solar4Kosovo".
2. Ky Vendim hyn në fuqi (15) pesëmbëdhjetë ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të MAPL- dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në web faqen e Komunës .

-T'i dërgohet  
-Kryetarit  
-Nënkryetarit  
- Kryesueses  
- Anëtarëve të KK  
- DPUKP  
-MAPL  
-Arkivit

Anëtari më i vjetër i Kuvendit Komunal

Enver Gashi



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBIËQIT-OBILIC

CREKTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPËSTE ADMINISTRACIJE



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosova  
Komuna e Obiliqit - Opština Obilić - Municipality Obiliq



## Zyra e Kryetarit

### Kabinet Predcednika/ Office of the Mayor

Datë/Data/Date:	16 Tetor 2023
Nga/Od/From:	Xhafer Gashi – Kryetar i Komunës
Për/Za/To:	Kryesuesen e Kuvendit – Vlora Mjekiqi Kabashi
CC	Komitetin për Politikë dhe Financa Anëtarët e Kuvendit
Tema/Subjekat/Subject	Kërkese

E nderuara Kryesuese e Kuvendit .  
Të nderuar anëtar kuvendit .  
Të nderuar anëtar të Komitetit për Politikë dhe Financa .

Po ju drejtohet me anë të kësaj kërkesë për miratim nga ana e juaj dy Marrëveshje bashkëpunimi me Komunën e Prishtinës.  
Bazuar në Ligjin Nr .04/L-010 PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL , NENI 8 , pika 2 .

Bazuar në Vendimin nr I-179 , të datës 29.12.2022 për të hyrë në bashkëpunim nder komunal .  
Dhe autorizimin për ti filluar konsultimet për marrëveshje për bashkëpunim ndërkomunal .  
Ne kemi punuar me grupet punuese të Komunës sonë dhe të Kryeqytetit-Komunës së Prishtinës për disa muaj deri ne finalizimin e dy Marrëveshjeve .

1. Marrëveshja me Nr-II-1337 dt.26.09.2023  
Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës ,Prishtinë për “ Realizimin e Projektit të Ngrohjes Diellore ”Solar4Kosovo”
2. Marrëveshja me Nr-II-1338 dt.26.09.2023  
Marrëveshje Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Obiliqit dhe Kryeqytetit të Republikës së Kosovës ,Prishtinë për “ Realizimin e Projekteve që Dalin nga Marrëveshja e Projektit të Ngrohjes Diellore Solar4Kosovo ”

Po ashtu për informimin tuaj gjeni edhe Memorandumin e Mirëkuptimit i lidhur mes Komunës së Obiliqit dhe KEK-ut , nr II-729 dt.01.03.2023.

Ju faleminderit për mirëkuptim !



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E OBILIQIT-OPSTINA OBILIC  
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME  
UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE



Dalës-izliznno

Nr. 1-179  
Br.

Data 29.12.2022  
Datum

OBILIQ OBILIC



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosova**  
**Qeveria - Vlada - Government**

**Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq**

Në mbështetje të nenin 12 pika d), neni 40 pika j) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr 04/L-010 për Bashëpunim Ndërkomunal ), neni 44.1 , neni 44 , pika 2 .11 dhe 47.3, të Statutit të Komunës Nr.I-34 të datës 25.04.2016, si dhe neni 39 të Rregullores së punës së Kuvendit nr.I-95,dt.29.06.2018, Kuvendi komunal pas shqyrtimit të kërkesës së Kryetarit nr. -II-1785, të dt.14.12.2022, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt.29.12.2022, mori këtë:


**VENDIM**

1. Miratohet nisma e Kryetarit të Komunës së Obiliqit, Nr.-II-1785 , të datës 14.12.2022 për të hyrë në bashkëpunim ndër komunal .
2. Bashkëpunimi ndër komunal do të zhvillohet me Komunat si në vijim :
  - 2.1.Komunës së Obiliqit ,
  - 2.2.Komunës së Prishtinës - Kryeqyteti i Kosovës
  - 2.3.Komunës së Fushë Kosovës ,
  - 2.4.Komunës së Lipjanit ,
  - 2.5.Komuna së Graçanicës,
  - 2.6. Komunës së Podujevës
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Obiliqit për të filluar konsultimet me komunat për përgaditejn e propozim marrëveshjes për bashkëpunim ndërkomunal .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyren e protokolit të MAPL-së, si dhe 7 ditë pas publikimit në web faqen e Komunës.


T'i dërgohet

- Kryetarit
- Nënkryetarit
- Kryesueses
- Anëtarëve të KK
- DAP
- MAPL
- Arkivit





**KOMUNA E  
OBILIQIT**



**KOMUNA E  
PRISHTINËS**

## MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Ndërmjet

Komunës së Obiliqit

dhe

Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës

për

**“Realizimin e Projekteve që Dalin nga Marrëveshja  
për Realizimin e Projektit të Ngrohje Diellore  
Solar4Kosovo”**

**Neni 1**  
**Palët Nënshkruese**

- 1.1 Komuna e Obiliqit, të cilën e përfaqëson Kryetari i Komunës së Obiliqit, Xhafer Gashi; dhe
- 1.2 Kryeqyteti i Republikës së Kosovës, Prishtina, të cilin e përfaqëson Kryetari i Kryeqytetit, Përparim Rama

**Neni 2**  
**Qëllimi i Marrëveshjes**

- 2.1 Qëllimi i kësaj marrëveshjeje në mes palëve nënshkruese është realizimi i projekteve të cilat do të implementohen nga komuna e Prishtinës në territorin e komunës së Prishtinës dhe Obiliqit, si obligime që dalin nga marrëveshja për realizimin e projektit të ngrohjes diellore "Solar4kosovo.
- 2.2 Komuna e Prishtinës merr përgjegjësinë që të kryejë të gjitha obligimet financiare për realizimin e projekteve të cilat janë cekur në pikën 3.2 të nenit 3 të kësaj marrëveshje.

**Neni 3**  
**Lista e projekteve**

- 3.1 Projektet të cilat do të realizohen brenda periudhës 1 deri në 3 vjeçare nga nënshkrimi i kësaj marrëveshje.
- 3.2 Lista e projekteve të cilat do të realizohen nga Komuna e Prishtinës:
  - 3.2.1 Vazhdimi i kolektorit nga fshati Shkabaj KK.Prishtinë i cili shkarkohet në fshatin Dardhishtë - Obiliq, i cili kolektor duhet të vazhdohet nga fshati Shkabaj deri te lumi Sitnica në Dardhishtë gjatësia e këtij kolektori është përafërsisht L=3,800m.
  - 3.2.2 Zgjerimi rrugës tek Zona Industriale në Llazarevë – Obiliq, rruga është e ngushtë dhe kalon nëpër prona private ku është e domosdoshme të bëhet shpronësimi në gjatësi të përafërt rreth L=100m.
  - 3.2.3 Rruga te potoku në Mazgit prej Gazemistanit deri te kyçja në M2 me gjatësi afërsisht L=800m, rruga në fjalë ka qenë rrugë e vjetër me kalldrëm e cila një pjesë është në pronësi të KK Obiliq dhe një pjesë të KK Prishtinë.
  - 3.2.4 Ndërtimi i kanalizimit i cili vjen nga fshati Bardhosh-Trudë nga komuna e Prishtinës dhe shkarkohet në fshatin Bakshi dhe Raskovë në Komunën e Obiliqit kolektori në fjalë ka gjatësi L= 3,820m prej Autostradës deri te lumi Llap.
  - 3.2.5 Finalizimi i projektit i quajtur Unaza që kalon në territorin e komunës së Obiliqit dhe të bëhet caktimi i lokacionit te varrezave për lagjen Hade e re në Shkabaj.
  - 3.2.6 Trajtimi dhe gjelbërimi i hyrjes në Obiliq në fshatin Shkabaj (nga ura e magjistrales Prishtinë - Mitrovicë deri tek rrethi).
  - 3.2.7 Ri-aktivizimi i linjës së Trafikut Urban në relacionin Prishtinë - Obiliq përkatësisht ndarja e flotës prej 6 autobusë për të njëjtën linjë.

- 3.3. Komuna e Prishtinës përmes N.P”Termokosit” do të angazhohet për të mundësuar kyçjen e Komunës së Obiliqit në sistemin e ngrohjes përmes ko-gjenerimit. Projektet të cilat e trajtojnë çështjen e ngrohjes për Komunën e Obiliqit janë:
- 3.3.1. Projekti “Economic Resilience Initiative, Infrastructure Technical Assistance “ - AA-000901-001-ERI-ITA i financuar nga Banka Evropiane për Investime EIB - parasheh dyfishimin e kapacitetit të ko-gjenerimit nga KEK për Ngrohoren e Prishtinës. I njëjti parasheh ndarjen e një kyçje të veçantë për qytetin e Obiliqit. Në stacionin e nxjerrës së nxehtësisë do të ketë një dalje të veçantë për Obiliqin me kapacitetin termik deri në 40 MWth. Kjo është e përfshirë në projektin ERI-ITA nga i cili do të mbulohen shpenzimet e investimit me rastin e realizimit.
- 3.3.2. Komuna e Prishtinës përmes N.P”Termokosit” do të angazhohet që Komuna e Obiliqit të marrë përkrahje në sigurimin e investimeve që përfshinë tubacionin nga stacioni për nxjerrjen e nxehtësisë (pika e kyçjes) deri te stacioni për pranimin e nxehtësisë, përmes projekteve aktuale duke përfshirë edhe Western Balkans Investment Framework Infrastructure Project Facility Technical Assistance 10 (IPF 10), AA-010071-001; WB21-KOS-ENE-01-Sub-project: Kosovo, District Heating Systems: Feasibility Study, ESIA, financuar nga Banka Evropiane për investime EIB (Studimi i Ngrohjes për 8 qytete). Në rast të mos realizimit të këtij projekti, Komuna e Prishtinës zotohet se do të siguroj financimin e këtij projekti.

#### **Neni 4**

#### **Obligimet e Komunës së Obiliqit**

- 4.1 Komuna e Obiliqit e merr përsipër që t’i sigurojë projektet detale të cekura në nenin 3.2 të kësaj marrëveshje brenda afatit prej 3 muajve nga data e nënshkrimit të marrëveshjes.
- 4.2 Komuna e Obiliqit obligohet që t’i sigurojë të gjitha lejet e nevojshme në bazë legjislativitetit në fuqi të cilat kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të cilat gjenden në territorin e Komunës së Obiliqit.
- 4.3 Komuna e Obiliqit obligohet para fillimit të realizimit të projekteve të caktojë një mbikëqyrës të punimeve të cilat janë objekt i kësaj marrëveshje.

#### **Neni 5**

#### **Obligimet e Komunës së Prishtinës**

- 5.1. Komuna e Prishtinës obligohet që të zhvillojë të gjitha procedurat e prokurimit lidhur me projektet të cilat janë cekur në pikën 3.2 të nenit 3 të kësaj marrëveshje.
- 5.2 Komuna e Prishtinës obligohet që t’i sigurojë të gjitha lejet e nevojshme në bazë legjislativitetit në fuqi të cilat kanë të bëjnë me realizimin e projekteve të cilat gjenden në territorin e Komunës së Prishtinës.
- 5.3 Komuna e Prishtinës obligohet që të caktojë personat përgjegjës për përcjelljen e punimeve lidhur me projektet që janë objekt i kësaj marrëveshje të bashkëpunimit.

- 5.4 Komuna e Prishtinës obligohet që pas përfundimit të realizimit të projekteve ta njoftojë me shkrim Komunën e Obiliqit për realizimin e projekteve që janë objekt i kësaj marrëveshje, dhe të dorëzojnë një kopje të kontratave dhe pranimeve përfundimtare.
- 5.5 Komuna e Prishtinës obligohet që t'i realizojë të gjitha pagesat lidhur me implementimin e projekteve që janë objekt i kësaj marrëveshje.

## **Neni 6**

### **Vlefshmëria dhe zbatueshmëria e Marrëveshjes**

- 6.1 Marrëveshja është me karakter obligativ dhe krijon detyrime ligjore për palët nënshkruese.
- 6.2 Kjo marrëveshje do të fillojë të zbatohet konform nenit 3.1 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- 6.3 Marrëveshja është e vlefshme dhe prodhon efekte juridike deri në momentin e finalizimit të projekteve të specifikuar në pikën 3.2 të kësaj marrëveshje bashkëpunimi.
- 6.4 Palët mbajnë të drejtën e shkëputjes së kësaj marrëveshjeje në rast se konstatojnë se nuk po përmbushen obligimet që dalin nga kjo marrëveshje në pajtim me qëllimin e marrëveshjes.
- 6.5. Në rast të kontestit, palët mund të zgjidhin mosmarrëveshjet edhe në procedurë gjyqësore në gjykatën kompetente.

## **Neni 7**

### **Hyrja në fuqi**

- 7.1 Kjo marrëveshje fillon zbatimin pasi që të merr miratimin nga Kuvendi i Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, Prishtinës si dhe nga Kuvendi Komunal i Obiliqit, në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal.
- 7.2. Kjo Marrëveshje është lidhur në pajtim me vendimin e Kuvendit të Kryeqytetit, Prishtinës me nr. 01-020/02-177566, të datës 26.07.2023 si dhe të vendimit të Kuvendit Komunal të Obiliqit me nr. prot. -1-179 të datës 29.12.2022.
- 7.2 Kjo marrëveshje do të nënshkruhet në katër (4) kopje origjinale në gjuhën shqipe, nga dy (2) kopje për secilën palë.

Xhafer Gashi  
Kryetar  
Komuna e Obiliqit



Përparim Rama  
Kryetar  
Kryeqyteti i Republikës së Kosovës,  
Prishtina

